



OUR MATTERS

2013 - 2015

OUR MATTERS

Disclaimer: This report presents solely the views of the project and does not in any case presents the views of PAX.

Përmbajtja

1. Historiku “Our Matters”	4
2. Konkluzionet e ciklit të debatit për Çështjet tona	5
3. Vëzhgimet kryesore	5
4. Rekomandimi i përgjithshëm	6
5. Faza e parë	7
5.1 Arsimi Gjithëpërfshirës.....	7
5.2 Dhuna në mesin e të Rinjëve.....	9
5.3 Politikat Kulturore për të Rinjët.....	10
5.4 Infrastruktura/Planifikimi Urban.....	11
5.5 Të drejtat e Pacientëve	11
6. Faza e dytë	12
6.1 Mungesa e Tualetëve Publike.....	12
6.2 Plani i Veprimit për Rininë.....	13
6.3 Aftësitë e Komunikimit.....	14
6.4 Dhuna në Familje.....	15
6.5 Siguria në Trafik	16
6.6 Ushqimi Nutritiv	17
7. Faza e Tretë	19
7.1 E Drejta e fëmijëve romë dhe zgjidhja e problemit të regjistrimit në shkollë të mesme.....	19
7.2 Barazia Gjinore... ..	19
7.3 Frymo Lirshëm – Zbatimi i Ligjit për kontrollin e duhanit.....	22
7.4 E Drejta Pronësore e Grave - regjistrimi i pronës së trashëguar.....	23
7.5 Proceset e Integritimit dhe Normalizimit nën Ombrellën e “Marrëveshjeve të Brukselit.....	24
7.6 Diskriminimi nuk është shaka – le të flasim për barazinë.....	26
8. Nevoja për vazhdim	27

HISTORIKU

“Çështjet tona” është projekt i cili implementohet nga Community Building Mitrovica (CBM) në partneritet me organizatën holandeze Pax (Paks). Projekti synon të rrisë pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes përmes debateve publike.

- Ekziston nevoja që të punohet në lidhje me pjesëmarrjen e publikut dhe ndërveprimin me institucionet vendore;
- Qasja direkte në Institucionet lokale me qëllim të rritjes së transparencës në përgjithësi nuk ka qenë aq efektive. Më efektive është të adresohet një problem i veçantë në qasjen e institucioneve lokale; Edhe kjo është më e besueshme ndaj qytetarëve.
- Shoqëria civile në vetvete sheh nevojën për të rritur besueshmërinë dhe cilësinë e saj duke qenë më transparente dhe duke punuar në mënyrë më profesionale, për nevojat e qytetarëve;

Pax dhe CBM në këtë mënyrë kanë vendosur të rregullojnë qasjen dhe të fillojnë të punojnë nga poshtë-lart për pjesëmarrjen e publikut, duke mbështetur shoqërinë civile në të njëjtën kohë, dhe adresuar probleme të veçanta duke avokuar në drejtim të institucioneve lokale.

Përmes debateve publike mbi tema që lidhen me jetën e përditshme, qytetarët ndjejnë se ata në mënyrë të hapur mund të shprehin mendimet e tyre për çështjet që i ndikojnë ata dhe të propozojnë zgjidhje për problemet ekzistuese, duke krijuar një mjedis më të përshtatshëm midis qytetarëve dhe komunave. Debatet kanë për qëllim të arrijnë deri tek dora e institucioneve lokale: Zyrtarët që punojnë në temën e diskutimit do të ftohen në debate.

Një tjetër qëllim i rëndësishëm është avokimi në lidhje me rezultatet e debateve. Rekomandimet mund të merren parasysh në avokimin ndërkombëtar të Pax-it, me fokus në Bashkimin Evropian.

Konkluzionet e ciklit të debatit për Çështjet tona

Mes Shkurtit të vitit 2013 dhe Dhjetorit të vitit 2015 trembëdhjetë OJQ-të: Youth Empowerment Center (*Qendra për fuqizimin e të rinjve*), Mission of People of Good Will (*Misioni i njerëzve me vullnet të mirë*), Inspiracija (*Inspirimi*), Center for Women Development (*Qendra për Zhvillimin e Grave*), Lëvizja Koha, Mitrovica Women Association for Human Rights (*Shoqata e Grave të Mitrovicës për të Drejtat e Njeriut*), AKTIV, Center for Legal Voluntering (*Qendra për Vullnetarizëm Ligjor*), PREZENT Marketing, Santa Marija, ACDC dhe Vredne Kolasinke (*Kollashinaset e vyeshme*) kanë bashkëpunuar në projektin Çështjet tona i cili është implementuar në tri faza. Ata organizuan debate publike dhe aktivitete në rrugë. Qëllimi i këtyre debateve ishte rritja e pjesëmarrjes së publikut për temat që kanë të bëjnë me jetën e përditshme. Përmes debateve, qytetarët mund haptazi të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjet që kanë ndikim tek ata dhe të propozojnë zgjidhje për problemet ekzistuese. Nëpërmjet aktiviteteve dhe organizimeve të ndryshme në rrugë, njerëzit u informuan dhe u ftuan në debate. Qëllimi i këtyre debateve ishte që të sigurohet hapësirë për ndërveprim mes zyrtarëve komunal dhe qytetarëve për tema të caktuara.

Ky raport përfshin vëzhgimet kryesore që rezultojnë nga projekti si dhe rekomandimet për tema.

Vëzhgimet kryesore

Në secilin debat, pjesëmarrësit kanë ngritur çështje të rëndësishme tashmë të njohura për shumicën e qytetarëve, por edhe disa të reja që duhet t'u adresohen zyrtarëve dhe

vendimmarrësve relevant në Mitrovicë. Në secilin debat janë ftuar vendimmarrësit relevant derisa në disa debate kanë qenë zyrtarë të pranishëm, ku kanë shprehur opinionet, kontributet e tyre dhe kanë dhënë përgjigje relevante për temën e cila ishte nën fushëveprimin e punës së tyre. Debatet ishin pikënisje dhe mjet shumë i mirë për ngritjen e çështjes për temën e zgjedhur, por ato shërbejnë edhe për vazhdimin e veprimit dhe qëllimin e projektit - avokim dhe lobim. Të gjitha organizatat kanë ngritur çështje të lidhura me Komunat për të kuptuar pse është praktikë e zakonshme që qytetarët të mos përfshihen në proceset e vendimmarrjes dhe si mund Komunat respektive dhe palët tjerë relevante të interesit të lidhen me qytetarët.

Të gjitha çështjet e përditshme ishin anketuar mjaft mirë nga organizatat dhe ekipi i projektit “Çështjet tona”.

Aktivitetet në rrugë kanë shërbyer edhe si mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin dhe informimin e njerëzve për problemet e ndryshme të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve të Mitrovicës, pa marrë parasysh nëse ata jetojnë në Veri apo Jug, problemet dhe shqetësimet janë të njëjta, dhe avokimi tek palët e interesit ka ende mangësi në të dy pjesët e qytetit.

Përveç kësaj ne do të diskutojmë të gjeturat dhe konkluzionet për secilën temë në kapitullin e radhës të raportit.

REKOMANDIMI I PËRGJITHSHËM

Rekomandimet e cekura më poshtë kanë ardhur si rezultat i secilit debat që është zhvilluar në kuadër të projektit “Çështjet tona”. Këto janë të përgjithshme dhe të nevojshme me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit në mes të institucioneve dhe shoqërisë civile.

Konkluzionet specifike shkojnë me temën specifike për të cilën është debatuar.

- Përfaqësuesit e Komunave duhet të jenë të hapur për bashkëpunim me sektorin e shoqërisë civile;
- Qytetarët duhet të bëjnë më shumë përpjekje dhe të kërkojnë të përfshihen në një proces të vendimmarrjes, sidomos kur është fjala për planifikimin e buxhetit/vitit financiar;
- Debatet publike të organizuara nga Komuna dhe organizata/institucione të ndryshme janë shumë të nevojshme;
- Komuna duhet të ndjek rregullat për informimin e qytetarëve për debatet publike. Ata duhet të krijojnë një mënyrë standarde për të informuar qytetarët për debate publike (ueb faqe, fletëpalosje, rrjete sociale të tilla si Facebook, Twitter, posterë, dërgesa, listë të adresave, etj.);
- Qytetarët duhet të jenë më të informuar për aktivitetet e organizuara nga komuna;
- Zyrtarët duhet të jenë më të përgjegjshëm dhe të hapur kur është fjala për raportim të punës që bëjnë/ nuk e bëjnë;
- Komuna në pjesën Veriore të Mitrovicës duhet të ndërtojë një bashkëpunim me komunat tjera në Veri të Kosovës dhe më gjerë, në ndarjen e shembujve të mirë që ata përdorin në punën e tyre të përditshme;
- OShC-të duhet të vazhdojnë të ngrisin çështjet që ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve;
- OShC-të duhet të ndërtojnë një platformë bashkëpunimi, kur është fjala për lobim dhe avokim për çështjet e jetës së përditshme;

FAZA E PARË

ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS

Në Shkurt të vitit 2013, Youth Empowerment Centre (*Qendra për fuqizimin e të rinjve*) ka organizuar debate publike me temë: **Si të përmirësohet gjithëpërfshirja në qytetin**

tonë - Qëllimi i debatit ishte të diskutohen aspekte të ndryshme të problemeve dhe polemikave rreth arsimit gjithëpërfshirës për të ofruar vendimmarrësve lokalë më shumë informacione mbi atë se çka është gjithë përfshirja dhe se si është administruar në qytetin tonë dhe për të kontribuar në pranimin dhe zhvillimin e arsimit gjithëpërfshirës. Prania e figurave të rëndësishme sociale, si vendimmarrës, praktikues nga sistemi arsimor, si dhe përfaqësues të sektorit civil ishte shumë e lartë.

Konkluzionet/rekomandimet

- Njohja e disa institucioneve lokale, si shkolla, Komuna, etj., të cilat deri në atë kohë nuk ishin të përfshirë në ofrimin e mbështetjes për futjen në funksion të arsimit gjithëpërfshirës;
- Metoda e mbështetjes sistematike është dashur të mundësojë decentralizimin dhe marrjen parasysh të problemit të futjes në funksion të gjithëpërfshirjes nga këndvështrimet e ndryshme. Ajo çfarë ka treguar procesi është konkluzioni se përvoja e keqe e praktikantëve në procesin e futjes në funksion të një mënyre të tillë të ndërlikuar, pa mbështetje sistematike ishte shumë sfidë e madhe për të qenë në gjendje të decentralizojë dhe rishikojë argumentet pro dhe contra të arsimit gjithëpërfshirës;
- Përshtatshmëria e ligjit për sistemin arsimor dhe përshtatjen e kushteve për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara është shoqëruar me përvoja të këqija të praktikantëve të cilët e kanë të vështirë të kryejnë rolin e tyre të ri;
- Ekzistojnë simptoma të djegies profesionale dhe rezistencë ndaj pranimin të ligjit. Kjo tregon nevojën për zbatimin e masave urgjente të cilat do të shërbejnë për të mbështetur profesionistët dhe për këtë arsye do të shërbente në të mirë të të gjithë fëmijëve;

- Duhet të ketë lidhje të krijuara ndër-sektoriale në mes të komisionit nga komuna e Mitrovicës dhe Fakultetit Filozofik, Departamentit të Psikologjisë (Universiteti i Prishtinës përkohësisht i zhvendosur në veri të Mitrovicës);
- Duhet të ekzistojë një bashkëpunim funksional në mes të komisionit nga komuna e Mitrovicës dhe Fakultetit Filozofik, Departamenti i Psikologjisë. Departamenti i Psikologjisë (studentët në vitin e fundit të fakultetit si dhe asistentët dhe profesorët e tyre) do të ofrojnë trajnime, lloje të ndryshme të arsimit, këshillim, etj., Komisionit ndër-sektorial dhe të tjerëve që janë të përfshirë;
- Duhet të krijohet strategji lokale dhe objektiva afatgjatë për arsimin gjithëpërfshirës;

DHUNA NË MESIN E TË RINJVE

Debati i dytë u organizua në Mars të vitit 2013 nga Mission of People of Good Will (*Misioni i njerëzve me vullnet të mirë*), dhe tema ishte **Dhuna në mesin e të rinjve**. Qëllimi i debatit ishte dhënia e rekomandimeve nga akterët relevantë sociale për të parandaluar ngacmimet dhe dhunën në mesin e të rinjve. Përmes veprimit në rrugë, është identifikuar nevoja për një temë të tillë si dhe rëndësinë e mbledhjes së palëve të interesit së bashku rreth tryezës, për të diskutuar hapur rreth problemeve që prekin të rinjtë, sidomos dhunën e cila është rritur viteve të fundit.

Konkluzionet/rekomandimet

- Është vërejtur se burimet lokale nuk janë vënë në shërbim, për të mbështetur fëmijët dhe të rinjtë;
- Nuk ka bashkëpunim formal në mes të shoqërisë civile dhe palëve të interesit në lidhje me këtë temë; Për këtë arsye ekziston nevoja të krijohet një bashkëpunim në mes të shoqërisë civile dhe shkollave me qëllim të ngritjes së vetëdijes në mesin e punonjësve, fëmijëve dhe të rinjve për dhunën e ushtruar nga kolegët/shokët;
- Është e nevojshme dhe shumë e rëndësishme që të vazhdohet me organizimin e punëtorive dhe trajnimeve me të njëjtën temë me nxënës dhe studentë;

- Trajnimi i studentëve dhe fëmijëve për ndërmjetësimin ku njerëzit fitojnë aftësitë e komunikimit të pa dhunshëm dhe parandalimin e konflikteve, dhe kjo do të transmetohet tek bashkëmoshatarët e tyre në shkollë;

POLITIKAT KULTURORE PËR TË RINJTË

AKTIV kishte organizuar debatin në Maj të vitit 2013 se si duhet rritur **përfshirjen e Komunës në zhvillimin kulturor të të rinjve** në bazë të një anketimi të kryer më parë në mesin e të rinjve (shkollë fillore dhe të mesme, fakultete). Pjesëmarrësit kanë identifikuar probleme në lidhje me jetën kulturore në Mitrovicë dhe përfshirjen komunale. Ka mungesë të aktiviteteve kulturore, dhe njerëzit nuk janë shumë aktiv në këtë sferë¹.

Konkluzionet/rekomandimet

- Të përfshihet numri i OShC-ve dhe individëve të cilët janë të interesuar të punojnë në këtë temë;
- Të organizohen, të krijohen shoqata, aktivizimi i të gjithëve, krijimi i “Klubit të Debatit”;
- Organizatat qeveritare dhe joqeveritare, dhe institucionet lokale duhet të punojnë së bashku për promovimin e kulturës;
- Krijimi i ueb faqes së përbashkët (institucionet dhe OShC-të që do të merren me çështje të kulturës);
- Promovimi i gjerë për punën e OShC-ve;
- Takime të përbashkëta në baza javore/mujore të të gjitha institucioneve, OShC-të dhe individët që merren me çështje kulturore;
- Miratimi i konkluzioneve, dërgimi i raportit mediave dhe informimi i publikut;

¹ Nenad Todorovic - Drejtori i teatrit, folësi kryesor i debatit

INFRASTRUKTURA/PLANIFIKIMI URBAN

CBM kishte organizuar debatin e katërt publik në Qershor të vitit 2013 në kuadër të ciklit të projektit “**Infrastruktura/Planifikimi Urban në veri të Mitrovicës - si është dhe se si unë do të doja që ajo të jetë**” për të diskutuar dhe adresuar çështjet e zhvillimit të dobët të infrastrukturës në Veri të Mitrovicës me akterët relevant dhe për të reflektuar mbi situatën aktuale dhe zonat e neglizhuara si dhe për zërin qytetarëve të lënë pas dore në këtë çështje. Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë probleme të ndryshme në lidhje me infrastrukturën, dhe shqetësimi kryesor në lidhje me temën ishte se qytetarët nuk janë të përfshirë në procesin e vendimmarrjes.²

Konkluzionet/rekomandimet

- Aktivizimi është mjeti kryesor për zgjidhjen e problemeve në Komunë, qoftë në infrastruktura apo sektorët tjerë;
- Komuna në Veri³ dhe Zyra Administrative në Mitrovicën e Veriut japin leje dhe gjendja në terren ndryshon;
- Kompanitë e ndërtimit nuk i përmbahen ligjeve të aplikueshme dhe nuk bëhet asnjë inspektim për të monitoruar procedurat e ndërtimit dhe përputhjes;
- Ngjyrat e ndërtesës të cilat ndikojnë në estetikën e qytetit duhet të jenë në përputhje me planifikimin urban dhe planifikimin arkitektural;
- Çështja më urgjente që duhet të zgjidhet është problemi i ujit dhe energjisë elektrike;

TË DREJTAT E PACIENTËVE

Tema e fundit e ngritur në ciklin e parë ishte nga OJQ Santa Marija, dhe atë për të **drejtat e pacientëve**. Qëllimi ishte të informohen njerëzit/pjesëmarrësit për të drejtat e tyre, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për njoftuar ofruesit e shërbimeve me të drejtat e qytetarëve dhe pacientëve në sistemin e kujdesit shëndetësor. Mjekët patën rastin që

² Bojana Vasic, arkitekthe, folëse dhe moderatorë e debatit

³ Komuna e udhëhequr nga serbët

qytetarëve t'u prezantojnë të drejtat e pacientëve. Pjesëmarrësit në debat bashkë me folësit u pajtuan për rekomandimet e mëposhtme sa i përket promovimit të të drejtave të pacientëve.

Konkluzionet/rekomandimet

- Të drejtat e pacientëve duhet të paraqiten në posterë, fletushka dhe broshura dhe të shpërndahen tek institucionet;
- Punëtorët e institucioneve shëndetësore duhet të jenë të trajnuar për aftësitë e komunikimit;
- Hapja e këshillimoreve për pacientët me diabet, të cilët mund të adresojnë nevojat e tyre dhe të konsultohen me profesionistë;
- Ekziston nevoja të vazhdohet me punën e këshillimoreve për gratë me kancer të gjirit (dhe ato që nuk kanë kancer, por që kanë të konsultohen) si dhe të sigurohet financim i qëndrueshëm nga institucionet apo edhe palët tjerë të interesit;

FAZA E DYTË

MUNGESA E TUALETEVE PUBLIKE

Faza e dytë e projektit “Çështjet tona”, ka filluar me OJQ-në Lëvizja Koha e cila kishte organizuar disa aktivitete në lidhje me temën e përmendur më lart. Aktivitetet në rrugë, dy debate publike dhe diskutime të hapura në shkollat e mesme e bënë hulumtimin shumë më të vlefshëm, të gjeturat dhe rekomandimet e dërguara te Komuna e Mitrovicës në Jug ishin konkrete dhe të adresuara shumë mirë.

Qëllimi kryesor i debateve ishte të diskutohet çështja dhe gjendja e tyre e tualeteve publike në Mitrovicë. Është thënë se tualetet publike inspektohen nga inspektorati komunal marrë parasysh rëndësinë e tyre⁴. Është theksuar rëndësia e temës duke përfshirë edhe problemin e mungesës së tualeteve publike në Mitrovicë, dhe

⁴ Naim Hajra, Drejtor i inspektoratit

përdorimin e atyre ekzistuese nga konsumuesit e drogës⁵. Pas debatit të parë, është kryer një anketim me qytetarët në rrugët e Mitrovicës së Jugut, të cilëve u kërkua të plotësojnë pyetësorët. Janë bërë edhe video në lidhje me temën me qëllim të ngritjes së vetëdijes së qytetarëve për rëndësinë e të pasurit tualete publike të cilat mirëmbahen si duhet. Të gjitha rekomandimet e bëra janë dërguar zyrtarisht Komunës, dhe ata janë zotuar që të përmirësojnë situatën.

Konkluzionet/rekomandimet

- Është nevojë urgjente që tualetet publike ekzistuese të bëhen funksionale;
- Tualetet publike duhet të mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme dhe të pastrohen mirë;
- Hapësirat rreth tualeteve duhet të kontrollohen vazhdimisht nga Policia e Kosovës, pasi që ekziston rreziku i lartë që njerëzit aty të përdorin drogë;
- Ekziston rreziku i lartë që të përhapen sëmundje rreth tualeteve publike;
- Institucionet lokale duhet të punojnë për të funksionalizuar tualetet publike përmes partneritetit publiko-privat, e që mund të jetë më e qëndrueshme;
- Duhet të paguhet një çmim nga shfrytëzuesit e tualeteve. Një çmim minimal i cili do të jetë i përballueshëm nga qytetarët. Paratë e mbledhura nga shfrytëzuesit e tualeteve mund të shërbejnë për mirëmbajtje dhe pagat e punonjësve;

PLANI I VEPRIMIT PËR RININË

OJQ “Prezent Marketing” ka organizuar një debat publik me temën “Plani i Veprimit për Rininë në Veri të Kosovës”. Qëllimi i debatit ishte ngritja e ndërgjegjësimit për të drejtat e të rinjve, si dhe marrja e iniciativave nga autoritetet kompetente - për të sjellë një plan të veçantë të veprimit për rininë dhe të përfshihen të rinjtë në krijimin e Asociacionit të Komunave.

⁵ Xhelal Shabani përfaqësues mjedisor

Konkluzionet/rekomandimet

- Të rinjtë në zonën e Mitrovicës janë pasiv dhe të painformuar për shkak të pasojave të luftës, si dhe pasivitetit të autoriteteve për të punuar në këtë çështje me të rinjtët, duke përfshirë këtu dhe situatën e paqëndrueshme politike;
- Janë bërë përpjekje nga OJQ të ndryshme në mënyrë që të zhvillohet plani i veprimit për rininë/strategjia por asnjëherë nuk është miratuar nga autoritetet edhe pas disa përpjekjeve të cilët shkuan huq (një nga shembujt është OJQ Santa Marija që ka propozuar strategji për rininë në Komunën e Zveçanit, por nuk u miratua asnjëherë);
- Të rinjtë duhet të inkurajohen në shkallë të gjerë në mënyrë që të socializohen siç duhet përmes aktiviteteve në fushën e aftësive sociale.

AFTËSITË E KOMUNIKIMIT *(këmbëngulësia e infermierëve dhe teknikëve me pacientët, familjet e tyre dhe mes njëri-tjetrit)*

“Santa Marija” ngriti çështjen e aftësive të komunikimit – këmbëngulësinë e infermierëve dhe teknikëve me pacientët, familjet e tyre dhe mes njëri-tjetrit. Debatu ishte vazhdimësi e debatit të parë publik të organizuar nga OJQ “Santa Marija” në temën “Të drejtat e pacientëve” dhe debati i dytë është organizuar për të zgjeruar këtë çështje dhe për të shtruar pyetjet se sa të drejta të pacientëve janë shkelur me mënyrën e komunikimit të punëtorëve mjekësor ndaj pacientëve dhe familjeve të tyre.

Konkluzionet/rekomandimet

- Nevojitet organizimi i debateve dhe tryezave të rrumbullakëta publike nga profesorët apo punëtorët tjerë relevant mjekësor përkatëse mjekësore në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi mbi këtë temë;

- Shumica e punëtorëve shëndetësor nuk janë në dijeni të ligjit dhe rregulloreve se si duhet të trajtohen pacientët dhe ligji duhet të respektohet;
- Duhet të organizohen tryeza të rrumbullakëta, debate publike dhe aktivitete të tjera për ngritjen e kësaj çështjeje të caktuar në shkallë më të madhe;
- Pjesëmarrësit në debat kanë konfirmuar se është e nevojshme të punohet në një zgjidhje për këtë problem i cili është gjithnjë e më i zakonshëm në spitale, si në veri të Mitrovicës dhe më gjerë. Pacientët janë në një pozitë të njëjtë të vuajtjes për të marrë shërbimin që ata kanë nevojë në atë moment, pasi ata as nuk janë të vetëdijshëm për të drejtat e pacientit, të cilat ishin shkelur në atë kohë. Pacientët janë duke u mësuar me një pozicion të tillë dhe se ata mendojnë se nuk mund t'a ndryshojnë atë;

DHUNA NË FAMILJE

AKTIV ka bërë anketime dhe ka mbuluar temën mbi dhunën në familje, bazuar në të gjeturat e mëhershme të dala nga një studim mbi përhapjen e dhunës në familje në Komunitet Veriore të Kosovës.

Konkluzionet/rekomandimet

- Nuk ekziston ndonjë stacion i përkohshëm i pranimit, strehimit dhe/ose ndonjë shtëpi e sigurve për viktimat e dhunës në familje në Komunitet Veriore të Kosovës.
- Kur është fjala për komunikimin ndër-institucional dhe komunikimin midis institucioneve përkatëse dhe grave me trauma të dhunës në familje, nuk ka kohë,

hapësirë dhe personel shtesë për të siguruar informacionin dhe orientimin e nevojshëm;

- Është dhënë një propozim për ngritjen e një qendre këshillimore, ku gratë mund të marrin mbështetje ligjore, këshillimore, psiko-sociale me kohë përfshirë çdo informacion tjetër përkatës;
- Gratë, në një përqindje të madhe, nuk e dinë numrin e telefonit të policisë. Kështu, roli i rëndësishëm i shoqërisë civile është të lidhë të gjitha informacionet nga burime të ndryshme dhe të komunikojë direkt me viktimat;
- Ekziston nevoja për të publikuar broshura, për të informuar, për t'iu qasur si dhe për të forcuar një grua në vend se të pritët nga një grua të qaset institucioneve;

SIGURIA NË TRAFIK

Qëllimi i këtij debati të organizuar nga OJQ "ACDC" ishte adresimi i problemit të abuzimit me alkool tek popullata e re në trafik nga këndvështrime të ndryshme dhe për të promovuar komunikimin me forcat e policisë dhe institucionet tjera, për të zvogëluar efektet negative të kësaj çështjeje. Pyetjet e ngritura gjatë zbatimit të projektit ishin: Cili është informacioni juaj në të dhënat statistikore, kur diskutohen aksidentet në trafik? Çfarë përcakton ligji në këto situata? Si reagon policia kur ndodhin këto lloje të problemeve?

Debati ka rezultuar në konkluzionet e mëposhtme: Problemi ekziston; ndikon në jetën e përditshme të secilit prej nesh në komunitetin tonë. Ne ishim në gjendje të identifikonim disa faktorë që ndikojnë në një sjellje të tillë.

Konkluzionet/rekomandimet

- Ndikimi i madh tek të rinjtë është mjedisi ku ata të jetojnë, i ndikuar edhe nga tradita;

- Pak a shumë është traditë të konsumohet alkool në raste të ndryshme;
- Disponueshmëria e alkoolit; Nuk ka rregullore ligjore që specifikon se alkooli nuk mund të shitet për të miturit, ose pas orës 22:00h;
- Numri i aksidenteve të trafikut është rritur ndjeshëm në krahasim me vitet e mëparshme;
- Forca policore ka të gjitha mekanizmat të ndalojë secilin shkelës të ligjit, pa marrë parasysh nëse është duke drejtuar makinën nën ndikim të alkoolit apo është duke bërë ngasje jo sipas rregullave, ose duke tejkalluar automjetet tjera kur nuk lejohet. Këto situata ndodhin në periudhën e adoleshencës, kur të rinjtë marrin lejen për vozitje dhe fillojnë të drejtojnë automjetin;
- Forca policore është duke punuar me intensitet më të lartë në krahasim me vitet e mëparshme. Ka shumë më tepër policë në rrugë dhe shumë më tepër kontroll.
- Pavarësisht nga fakti se policia ka të gjithë mekanizmat e nevojshme për të parandaluar shkeljet e ligjit, qytetarët e targetuar besojnë se mekanizmat nuk janë të mjaftueshme për të zgjidhur këtë problem;
- Një nga mekanizmat e mundshme mund të jetë gjoba financiare e cila nuk është adekuate;
- Në përgjithësi, ky është problem i shoqërisë në tërësi, problem i sistemit të vlerës, dhe problem i institucioneve publike, shkollave, mediave etj;

USHQIMI NUTRITIV

OJQ “Mitrovica Women Together for Human Rights (*Gratë e Mitrovicës së bashku për të Drejtat e Njeriut*)” ka implementuar një projekt me temën **ushqimi nutritiv**, duke ngritur çështjen e rëndësisë së cilësisë së ushqimit të konsumuar dhe atij të importuar në Kosovë, dhe sa njerëzit me të vërtetë kanë njohuri për cilësinë e ushqimit që konsumojnë. Inspektorati i komunës rregullisht kontrollon ushqimin që aktualisht është

në treg, dhe ka disa raste kur ushqimi është konfiskuar, për shkak të kushteve të këqija⁶. MWAHR ka bërë një hulumtim edhe me mjekët rreth të ushqyerit dhe të gjeturat u prezantuan në debat, para përfaqësuesve komunal të Mitrovicës së Jugut. Debatu ka rezultuar me disa rekomandime:

Konkluzionet/rekomandimet

- Edukimi shëndetësor është shumë i rëndësishëm për qytetarët dhe motoja është “konsumatori i informuar - është konsumator i vetëmbrojtur”;
- Inspektimi Sanitar - duhet të përcjellë se çfarë lloje të ushqimit shërbehen nga bizneset në treg;
- Ngritja e vetëdijes së pronarëve të bizneseve dhe konsumatorëve në lidhje me cilësinë dhe prodhimin e ushqimit;
- Qytetarët duhet të ndalojnë së bleri ushqim nga shitësit ambulantë;
- Ushqimi duhet të mbrohet dhe mbahet sipas standardeve të cilat në mënyrë të qartë përcaktohen përmes rregulloreve;
- Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e Konsumatorit është nevojë urgjente, për të mbrojtur qytetarët nga produktet jo të shëndetshme;
- Dogana duhet të ketë më shumë rregulla strikte për kontrollin e ushqimit të importuar;
- Qytetarët duhet të bashkëpunojnë me institucionet e qeverisjes lokale/inspektoratin e ushqimit për raportim dhe adresim të problemeve në lidhje me ushqimin jo të shëndetshëm;

⁶ Gene Kadriu, inspektor i ushqimit

FAZA E TRETË

E DREJTA E FËMIJËVE ROMË DHE ZGJIDHJA E PROBLEMIT TË REGJISTRIMIT NË SHKOLLË TË MESME

OJQ "Inspiracija" (*Inspirimi*) ka punuar në çështjen e **së drejtave të Romëve** gjatë muajit Nëntor të vitit 2015. Qëllimi i projektit ishte dhënia e kontributit publik dhe rritja e ndërgjegjësimit të Romëve mbi rëndësinë e ndjekjes së shkollës dhe rolin e tyre në ndikimin e ndryshimeve sociale për të gjithë komunitetin.

Është theksuar se ligji për arsim ka përcaktuar shumë mirë përfshirjen e pakicave etnike në shkollat e mesme⁷. Cilësia e jetës së Komunitetit Rom si një nga kategoritë e varfra të popullsisë është në nivel të ulët dhe ka nevojë për përmirësim urgjent⁸.

Konkluzionet/rekomandimet

- Fëmijët Rom jetojnë në një gjendje shumë të keqe, ata kanë nevojë për ndihmë dhe përmirësim urgjent të kushteve të jetesës;
- Organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet duhet të ndihmojnë në integrimin e fëmijëve Rom në aktivitetet e jetës së përditshme;
- Institucionet dhe palët tjerë të interesit duhet të ndihmojnë fëmijët Rom të largohen nga rrugët dhe të jetojnë një jetë më të mirë;

BARAZIA GJINORE

Si hyrje për **16 Ditët e aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore**, Nëntor – Dhjetor 2015 **Center for Women's Development** (*Qendra për Zhvillim të grave*) ka punuar për

⁷ Blagica Radovanovic, Asamblete

⁸Tatjana Ivaz, mësuese në shkollën fillore "Vuk Karadzic" në Zveçan,

barazinë gjinore. Çështjet që u sollën në diskutim në debatin e organizuar nga organizata e lartpërmendur kryesisht ishin fokusuar në statusin e grave në shoqëri.

- Duhet të bëhet vlerësimi i pozitës aktuale politike, sociale dhe ekonomike të grave në Mitrovicën e Veriut;
- Ekziston nevoja për të përfshirë gratë në sfera të ndryshme, që kanë më shumë ndikim, si në politikë, në pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ, si dhe në pozita menaxhuese;
- Gratë në zonat rurale, gratë pa të ardhura të përhershme personale, nënat e vetme, gratë me trauma të dhunës në familje, gratë me aftësi të kufizuara, etj., janë të privuara financiarisht dhe shoqërisht;
- Marrëdhënia dhe komunikimi i institucioneve ndaj grave duhet të përmirësohet;
- Ekziston nevoja për mekanizma ligjor që sigurojnë barazinë gjinore si dhe për tejkalimin e sfidave në ligjin ekzistues të cilat nuk janë zbatuar;
- Duhet të zhvillohen ligjet lokale, planet e veprimit, strategjitë dhe planifikimi i buxhetit në raport me statusin e grave;
- Duhet të krijohet komunikimi i grave përfaqësuese në Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Veriut me trupin e tyre elektoral, sidomos me gratë në zonat rurale dhe të mirëmbahen këto raporte në mënyrë të vazhdueshme.
- Është e nevojshme të krijohet një agjenci për dado, dhe të zhvillohen planet e ardhshme për të mbështetur krijimin e një departamenti gjinor brenda Komunës së Mitrovicës së Veriut⁹.

Qasja preventive edukative në punën me të rinjtë të të dy gjinive është prezantuar në debat. OJQ-të tjera po ashtu punojnë në ndryshimin e sjelljeve dhe qëndrimeve të cilat prodhojnë dhunë me bazë gjinore, përmes trajnimeve, shfaqjeve teatrore dhe veprimeve të ndryshme të informimit publik.¹⁰

⁹ Sanja Krtinić, Center for Women's Development (Qendra për Zhvillimin e Grave)

¹⁰ Stefan Veljković, Klubi për edukimin e të rinjve "Sinergija"

Pjesëmarrës të tjerë po ashtu ndanë probleme të tyre për barazinë gjinore, u theksua se një nga pengesat është buxheti i kufizuar që kanë institucionet¹¹. Gjithashtu, pozita e palakmueshme politike, ekonomike dhe sociale e grave në zonat rurale, duke u fokusuar në mungesën e komunikimit të duhur me institucionet e shërbimeve sociale dhe pushtetit vendor ndikon në statusin e grave¹².

Konkluzionet/rekomandimet

- Cilësia e jetës së grave nga kategoritë e varfra të popullsisë është në nivel të ulët dhe ka nevojë për përmirësim urgjent;
- Gratë nga zonat rurale, të angazhuar në punën më të vështirë që nuk paguhet në bujqësi, duhet të kenë qasje më të mirë në informata për shërbimet mbështetëse në dispozicion;
- Institucionet duhet të fillojnë të punojnë më shumë drejt politikës së dyerve të hapura dhe të zvogëlojnë hendekun e komunikimit në mënyrë që të plotësojnë në mënyrë efektive nevojat e përfituesve;
- Nënata e vetme janë të njohura si grupi më i cenueshëm, që përballet me stigmatizim dhe auto-stigmatizim;
- Kur është fjala për qeverisjen lokale dhe Komuna e Mitrovicës së Veriut, si pjesërisht të bazuar, buxheti është shumë i kufizuar dhe nuk shpreh nevojat aktuale të popullatës;
- Zyrtari për barazi gjinore ka mjete të kufizuara për të kryer ndonjë aktivitet;
- Qasje më e mirë në informata në faqen zyrtare të Komunës sa i përket informacioneve mbi ligjet, strategjinë e zhvillimit (qendrore dhe lokale) dhe planet e veprimit (lokale dhe qendrore), të cilat janë të rëndësishme për gratë;

¹¹ Adrijana Hodžić, shefe e Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut

¹² Ana Marija Ivković, hulumtuuese e lartë për studimin: "Gjinia që ka rëndësi: Varfëria dhe përfshirja sociale - mbrojtja sociale. Statusi Rural në Kosovë dhe Serbi", Center for Communities Development (Qendra për Zhvillim të Komuniteteve)

- Informacione në lidhje me shërbimet dhe institucionet në dispozicion për gratë (lokale dhe qendrore);
- Informacionet kontaktuese me emrat dhe pozitat e zyrtarëve që punojnë në shërbime për gratë;

FRYMO LIRSHËM – Zbatimi i Ligjit për kontrollin e duhanit

Qëllimi i këtij projekti të implementuar gjatë Nëntorit – Dhjetorit të vitit 2015 nga “Lëvizja Koha” ishte avokimi për zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit në Mitrovicën e Jugut. Sondazhi i kryer ka treguar se ekziston një nevojë urgjente për zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit¹³. Rolin kryesor në këtë drejtim e luan Drejtoria e Inspektoratit në kuadër të Komunës së Mitrovicës së Jugut. “Janë pesë inspektorë sanitarë të cilët inspektojnë bare lokale të qytetit, përfshirë edhe hapësira të tjera publike”, tha Naim Hajra Drejtori i Inspektoratit në Komunë. Gjithashtu janë lëshuar gjoba për bizneset për mos zbatimin e ligjit. Nga puna e përditshme inspektuese, shihet se ende ka nevojë për fushata të ndërgjegjësimit për rëndësinë e ligjit që të respektohet nga qytetarët.¹⁴

Për shkak të shkeljes së ligjit, është prekur edhe shëndeti i qytetarëve. Hapësira publike nuk është kontrolluar, dhe njerëzit e thithin konsumimin e duhanit në mënyrë pasive në vende publike¹⁵.

Konkluzionet/rekomandimet

- Ende ekziston nevojë për fushatat e ndërgjegjësimit - Rëndësia e ligjit që do të respektohet nga qytetarët;

¹³ Erzen Isufi koordinator i OJQ Lëvizja KOHA

¹⁴ Naim Hajra Drejtori i Inspektoratit

¹⁵ Nystret Ymeri, Instituti i Shëndetit Publik në Mitrovicë

- Roli i institucionit duhet të merret më seriozisht në ndëshkimin e atyre që nuk e respektojnë ligjin;
- Inspektorati duhet të bashkëpunojë më shumë me qytetarët në lidhje me këtë çështje;
- Qytetarët duhet të jenë shumë më aktiv në raportimin e shkeljeve të ligjit;
- OShC-të duhet të përqendrohen në zbatimin e projekteve me fokus në zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit;

E DREJTA PRONËSORE E GRAVE - REGJISTRIMI I PRONËS SË TRASHËGUAR

MWAHR ka implementuar këtë projekt në të gjithë qytetin. Hulumtimi i përgatitur ka treguar se qytetarët nuk janë të informuar për kornizën ligjore për të drejtën pronësore të grave, edhe pse ata janë të gatshëm dhe kanë vullnet të pranojnë se gratë kanë të njëjtën të drejtë për pronën siç e kanë edhe burrat.

Për shkak të traditave patriarkale dhe tranzicionit, jo më shumë se 10% e grave kanë pronë në emrin e tyre¹⁶. Edhe pse ekzistojnë ligje të cilat rregullojnë të drejtën e pronës, debatei pse ky ligj nuk zbatohet në praktikë mbetet ende i heshtur¹⁷. Gjithashtu, ka raste të rralla, kur burri regjistron pronën në emër të gruas së tij, si dhe, kur kjo ndodh, është e pamundshme për Drejtorinë për Gjeodezi ta bëjë këtë, për shkak se kontrata është nënshkruar vetëm në emër të burrit.¹⁸

Konkluzionet/rekomandimet

- Zyrtarët Komunal duhet të punojnë në përgatitjen e një pemë familjare, dhe kjo do të shërbejë për institucionet dhe qytetarët të dinë se kush cilës familje i takon;

¹⁶ Besa Veseli, zyrtare gjinore në Komunën e Mitrovicës së jugut

¹⁷ Ubejd Gashi, Avokat

¹⁸ Hasime Barku, përfaqësuese e Drejtoratit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

- Ligji i trashëgimisë duhet të zbatohet dhe të njihet nga qytetarët;
- Marrëveshja mbi pronën duhet të jetë në emër të të dy bashkëshortëve;
- Duhet të organizohen fushata ndërgjegjësimi në vazhdimësi për qytetarët për të drejtat e pronës;
- Arsyeja kryesore pse gratë nuk kanë pronë në emrin e tyre është për shkak të shoqërisë patriarkale;
- Ekziston një nevojë të vazhdohet me aktivitete të tjera me tryeza të rrumbullakëta dhe ngjarje të tjera publike, dhe në mesin e të ftuarve duhet të jetë edhe një Sociolog, Teolog të cilët do të japin më shumë shpjegime profesionale në lidhje me problemin;

PROCESET E INTEGRIMIT DHE NORMALIZIMIT NËN OMBRELLËN E “Marrëveshjeve të Brukselit”

OJQ Center for Legal Voluntering (Qendra për Volunterizëm ligjor) ka implementuar projektin për **Integrim dhe proceset e normalizimit nën ombrellën e “Marrëveshjeve të Brukselit” dhe zbatimin e tyre praktik në nivel lokal**, me fokus kryesor në “Integrimin e sistemeve gjyqësore, arsimore dhe shëndetësore në sistemin institucional të Kosovës - metodologjia, afatet kohore, pengesat dhe rezultatet e pritura me interes në dobi të komuniteteve lokale në veri të Kosovës”

Pyetjet e ngritura gjatë zbatimit të projektit, për të cilat ende mungojnë përgjigjet, janë:

- Në çfarë mënyre “Marrëveshja e Brukselit” përcakton kthimin e pronës së okupuar dhe a është kjo temë pjesë e marrëveshjes?
- A do të krijohet Gjykata Komunale në Veri të Mitrovicës, e cila është dashur të integrohet në sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe kur?
- A do të transferohen rastet nga Gjykatat serbe në Gjykatat e sapokrijuara?

- A do të vazhdojë Qeveria Serbe me pagesat për të punësuarit në Drejtoratin e Shëndetësisë, apo ata do të detyrohen të nënshkruajnë kontrata të reja të punës në Kosovë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe të marrin pagesa vetëm nga Kosova?
- A do të marrin qytetarët në Veri targat KS ose RKS dhe cili është afati i fundit për këtë? A ka ndonjë taksë ose sigurim shtesë të cilën njerëzit në veri të Mitrovicës do të duhet të paguajnë nëse përdorin automjete me targa të tilla, kur të hyjnë në Serbi?
- A janë të detyruar qytetarët në Veri të paguajnë energjinë elektrike të Kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike të Kosovës? Në rast se qytetarët nuk paguajnë çdo muaj do të energjia elektrike do tu ndërpritet.
- Çfarë po ndodh me ish-anëtarët e Gardës Civile të cilët ende nuk janë integruar në institucionet e Kosovës?
- A lejon kjo Marrëveshje Qeverinë Serbe të vazhdojë me pagesat shtesë në Kosovë?
- Çfarë do të ndodhë me punonjësit e kompanive publike në pronësi të Serbisë? A do të vazhdojnë të kenë vitet e tyre të shërbimit?
- Deri kur Menaxhmenti i përkohshëm Komunal do të jetë në fuqi?

Konkluzionet/rekomandimet

- 1) Shumica dërmuese e pjesëmarrësve arriti në përfundim se i tërë procesi i marrëveshjeve ishte jo transparent nga të dyja palët dhe se qytetarët nuk janë përfshirë në diskutime të hapura, duke rezultuar në mosdije në shumicën e asaj që ishte rënë dakord dhe që ka ndikim të madh në jetën e tyre të përditshme;
- Të gjithë pjesëmarrësit e kanë mirëpritur këtë tryezë pasi këshilltari ligjor, i pranishëm në debat, ishte në gjendje t'i përgjigjej disa prej pyetjeve të shtruar.
 - Këso lloj sesionesh informative duhet të organizohen në baza të rregullta, jo vetëm në Debate të hapura, por edhe përmes mediave, ku ekspertët vendorë do të

shpjegojnë marrëveshjet pjesës më të gjerë të audiencës të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve;

- Është rekomanduar të organizohen disa debate të hapura duke përdorur të njëjtën metodologji, por me pjesëmarrjen e politikanëve lokalë të cilët mund të përgjigjen pyetjeve për çështje që kanë të bëjnë me qeverisjen lokale;

DISKRIMINIMI NUK ËSHTË SHAKA – LE TË FLASIM PËR BARAZINË

Sipas projektit **Diskriminimi nuk është një shaka - le të flasim për barazinë**, OJQ **Vredne Kolasinke (Kollashinaset e vyeshme)** nga Komuna e Zubin Potokut, ka implementuar shumë aktivitete me qëllim kryesor për të nxjerrë në pah çështjen e diskriminimit dhe problemet e barazisë në shoqërinë tonë. Duke filluar nga shfaqjet teatrale¹⁹ fëmijët kishin identifikuar diversitetin dhe diskriminimin. Shfaqja kishte ngritur vetëdijen e fëmijëve në lidhje me diskriminimin; ata e pranuan diversitetin. U kuptua se kjo është rruga e drejtë për të filluar me zhdukjen e diskriminimit në shoqëri që nga mosha e re.

Gjatë projektit u ngrit çështja e zbatimit të ligjit, e cila është nën mesatare të zbatimit standard. Për shkak të mungesës së zbatimit të ligjit, qytetarët po përballen me diskriminim dhe trajtim jo të barabartë nga institucionet dhe shoqëria si e tillë.

Konkluzionet/rekomandimet

- Diskriminimi është një çështje e madhe. Zbatimi i ligjit nuk është arritur për shkak të të kuptuarit të ulët të tij; diskriminimi ndodh shumë shpesh;

¹⁹ Ishte një shfaqje teatri, shfaqur nga një grup prej 10 vullnetarësh, studentë të Fakultetit Filozofik. Ata performuan shoun "rikë e shëmtuar" në institucionin parashkollor "Nashe Dete" për fëmijët, mësuesit dhe prindërit e tyre.

- Punonjësit në kopshtin e fëmijëve janë të arsimuar; ata rregullisht mbajnë seminare dhe punëtori për të punuar me fëmijët me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e tyre në arsimin parashkollor dhe në shoqëri;
- Punonjësit në kopshtin e fëmijëve kanë mungesë të infrastrukturës së përshtatshme dhe pajisjeve të nevojshme për zbatimin e njohurive të tyre të mësuara në arsimin formal dhe joformal;
- Qendra për Mirëqenie Sociale gjithashtu merret me çështjen e diskriminimit, por ka nevojë ta pranojë këtë problem si një problem të përgjithshëm shoqëror dhe duhet të gjejë mënyrë interesante për të rritur ndërgjegjësimin e fëmijëve dhe qytetarëve;
- Lobimi tek vetëqeverisja lokale për fëmijët me aftësi të kufizuara, në mënyrë që institucionet parashkollor të inkurajohen për mbështetje financiare, për përmirësimin e kushteve të punës dhe të fuqizohen për të punuar;

NEVOJA PËR VAZHDIM

Bazuar në tri fazat e projektit dhe temat e zhvilluara deri më tani, duhet të zhvillohet një proces i mëtejshëm. Mënyra të mundshme për vazhdim mund të jenë:

- Të përdoren temat dhe rekomandimet në serinë e parë të debateve për të nxitur dialogun intensiv dhe të përhershëm në mes të institucioneve lokale dhe qytetarëve për të zgjidhur problemet për këto çështje dhe për të nxitur një kulturë pjesëmarrëse;
- Të zhvillohen një seri debatesh në një cikël të përhershëm, me qëllim që të bëhen të njohura (një markë e vërtetë), që përfshin grupe të mëdha të njerëzve duke rritur kulturën pjesëmarrëse dhe duke nxitur debat të përhershëm publik për shërbimet lokale në Mitrovicë;
- Zhvillimi i një platformë të debatuesve publik mbi çështjet e ngritura deri më tani, në mënyrë që institucionet dhe qytetarët vazhdimisht të jenë pjesë e diskutimit në lidhje me problemet e jetës së përditshme;

- OJQ-të pjesë e projektit të punojnë për të krijuar një koalicion/rrjet jo formal mundësisht me të njëjtin emër të këtij projekti “Çështjet tona”, që do të shërbejë për të identifikuar dhe ngritur probleme të ndryshme që ndikojnë në jetën e qytetarëve;
- Krijimi i strategjisë për lobim dhe avokim do të përdoret nga OJQ-të e vogla për mbajtjen e institucioneve llogaridhënëse dhe transparente;



Community Building Mitrovica

Community Building Mitrovica

T: +381 (0) 28 530 335 • E: info@cbmitrovica.org • www.cbmitrovica.org

Str. Isa Boletini No: 11 / Confidence Area / 40000 Mitrovica South

Str. Sutjeska No: 70 / CRYM building (EX Viva) / Mitrovica North